



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 176, datë 11.09.2019

PËR

DEKLARIMIN E PËRFUNDIMIT TË PERIUdhËS SË TRANSFERIMIT TË PËRKOHSHËM TË GJYQTARIT BESMIR STROKA

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 147, pika 1 dhe 147/a, pika 1, germa “a”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 46 të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtareve dhe prokuroreve në Republikën e Shqipërisë”, në konsideratë të nenit 4, pikat 3, 6 dhe 8, të Rregullores së Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”, miratuar me Vendimin nr. 23, datë 07.02.2019, të ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Deklarimin e përfundimit të periudhës së transferimit të përkohshëm të gjyqtarit Besmir Stroka në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë, sipas vendimit nr. 06, datë 21.12.2018, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe kthimin e tij në pozicionin e mëparshëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.
2. Efektet e këtij vendimi të fillojnë më 01.10.2019.
3. Gjyqtari Besmir Stroka të përjashtohet menjëherë nga procedurat e shortit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë.
4. Një kopje e vendimit t’i njoftohet gjyqtarit Besmir Stroka, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR